

REPUBLICA E KOSOVES, REPUBLIKA E KOSOVES  
 KOMUNA E VITISE - OF VITINA  
 02-05-2018  
 02-370/03-387

	<p><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova-Republic of Kosovo</b>  <b>Komuna e Vitisë</b>  <b>Opstina Vitina-Municipality of Vitina</b></p>	
---	---	---

**ZYRA E PROKURIMIT**

**KONTRATË PËR FURNIZIM**

Nr.prokurimit	VI657	1 6	1350	1-3-6
Nr. brendshëm	VI657	1 6	0 1 6	1 3 6

TITULLI I KONTRATËS : ***Furnizimi me material stomatologjik***

**E LIDHUR NË MES TË**

Operatori ekonomik	Autoriteti kontraktues
<p>Ntp <b>ANDI DENT FERIZAJ</b></p> <p style="text-align: right;">Përfaqësuar nga:</p>	<p><b>KOMUNA E VITISË</b></p> <p style="text-align: right;">Përfaqësuar nga:</p>
<p><b>Adnan Balaj, drejtor</b></p>	<p><b>Fadil ABAZI, menaxher i prokurimit</b></p>
<p style="text-align: center;"> v.v</p>	<p style="text-align: center;"> v.v</p>

Titulli: Furnizimi me material stomatologjik..Nr. Prokurimit: VI657-18-016-136

## **PJESA B: KONTRATA**

**KOMUNA E VITISË**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe

**NTP ANDI DENTI, FERIZAJ**, (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

***Furnizimi me material stomatologjik***, me numër Identifikues **VI657-18-016-136**

### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë ***Furnizimi me material stomatologjik***

1.2 Kontrata hynë në fuqi ditën e nënshkrimit..

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **5** ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi **I Komuna e Vitisë**, do të jetë **Drejtoria e Shëndetsise- QKMF**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **5,438.98 €**;

Me fjalë: **Pesë mijë e katër qind e tridhjetë e tetë Euro. / 98 centi**

**Kontrata fillon së implementuari nga dita nënshkrimit 02.05.2018 dhe përfundon me 01.05.2019,**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas brezës përkatëse, nëse aplikohet).

### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

*[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno]*

*[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]*

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

[Kontrata perbehet me **shume** dërgesa]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

E hartuar në gjuhën **Shqip**<sup>2</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

**Për Ofruesin e furnizimeve**

**Për Autoritetin Kontraktues**

<b>Emri:</b>	<b>Adnan Balaj</b>	<b>Emri:</b>	<b>Fadil ABAZI</b>
<b>Pozita:</b>	<b>Drejtor</b>	<b>Pozita:</b>	<b>Menaxher i Prokurimit</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	02.05.2018	<b>Data:</b>	02/05/2018
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i **furnizimeve** duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

**Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për **12** muaj, pas pranimit të **[furnizimeve]** **[shërbimeve]** **[punëve]**.

**Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]** **[të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet]** **[te kryej ndonjë ose të gjitha punët]** brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] ] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 30 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## **Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykata themelore Gjilandege ne Viti* në pajtim me ligjin e Kosovës.

## **Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK	
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata përkatëse në Viti
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b><i>gjuha Shqipe</i></b>
	2.4	Porosia të bëhet 48 orë më herët, ndërsa liferimi i mallrave të kryhet brenda 48 orë më së largu nga porosia
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>Malli duhet të jetë i cilësisë së garantuar. Mallrat duhet të jene te kualitetit te larte, sipas kërkesave te autoritetit kontraktues, dhe tu pergjigjen formave standardeve ligjore, sipas kerkesave dhe nevojave praktike te perdorura deri tani ne QKMF.</i>
Inspektimi dhe testimi	19.2	<b><i>Menaxher i kontratës Vahile Haziri</i></b>
		<b><i>Kontrate njevjeqare, nga data e nenshkrimit deri ne perfundim</i></b>
Pagesa	20.1	<b><i>Pagesat për furnizimin e kryer do të bëhen sipas faturave te furnizimit dhe urdhër blerjeve</i></b>
Dorëzimi	21.3	<b><i>Dorezimi behet ne zyren e pranmit te mallit ne QKMF.-Viti</i></b>
<b><i>Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes</i></b>	31.2	Palet do te bejne te gjitha perpjekjet për te zgjidhur ne menyre miqsore te gjitha mosmarveshjet qe mund te ndodhin ne mes tyre sapo te shfaqet ndonje mosmarveshje , palet do te lajmrojne njera-tjetren me shkrim per poziten e tyre ne mosmarveshje dhe per ndonje zgjidhje qe ata konsiderojne se eshte e mundhme
<b><i>Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore</i></b>	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata themelore Gjilan- dega ne Viti në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]. <b><i>Gjykata themelore Gjilan- dega ne Viti</i></b>

02-05-2018  
02-370/01-388

	<b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova-Republic of Kosovo</b> <b>Komuna e Vitisë</b> <b>Opstina Vitina-Municipality of Vitina</b>	
ZYRA E KRYETARIT KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE		

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008) dhe nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 02 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

## V E N D I M

PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT PËR MBIKËQYRJEN E FURNIZIMEVE SIPAS  
KONTRATËS: **Furnizimi me material stomatologjik, nr.VI657-18-016-136**

### I.

*Vahile HAZIRI*, CAKTOHET menaxher i projektit për kontratës: **Furnizimi me material stomatologjik**

### II.

Menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi ka për detyrë që të bëjë:

- Menaxhimin e furnizimit të AK, të menaxhoj obligimet e AK sipas kontratës dhe të siguroj se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar,
- Të siguroj kontroll të kostove, cilësisë dhe sasisë dhe kohën e dërgesave (vonesave),
- Të siguroj arritjen e qëllimit të kontratës, fushëveprimit, spicifikacionit dhe përgjegjësit e AK dhe Furnizuesit.
- Të dorëzoj Planin e menaxhimit të kontratës dhe monitoron kontratën nga nënshkrimi deri në skadimin e saj.
- Të monitoroj furnizimet dhe pagesat e kryera nga kompania

### III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë dhe menaxheri nga neni 1 i këtij vendimi.

### IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Menaxherit,
2. Operatorit,
3. Zyrës së Prokurimit,
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË  
Sokol HALITI





Komuna e Vitise  
Municipality of Viti  
Opstina Vitina



Qendra kryesore e Mjekësisë Familjare  
„Nëna Tereze“ Viti

Paramasa per Furnizin me materjal Stomatologjik

Data:

Nr	Emertimi	Njesija	sasi	Çmimi	Totali
1	Alveogyl	Pako	6	25.00 €	150.00 €
2	Papier point	Pako	15	3.00 €	45.00 €
3	Brisk per dyllë	copë	10	0.30 €	3.00 €
4	Calcident(mbushje e but të kanalet e rrenjeve të femijet	copë	10	1.00 €	10.00 €
5	Calium hidrosid	Pako	12	10.00 €	120.00 €
6	Caps Amalgam 1 sipërfaqe dhe 2 sip	Pako	12	35.00 €	420.00 €
7	Cink oksid (Karifil)	Pako	6	9.00 €	54.00 €
8	Past devitalizuse me arsenik	Pako	12	0.30 €	3.60 €
9	Mbushje definitive per kanale	Pako	9	28.00 €	252.00 €
10	Fisurit(mbushje per vulosjen e fisurave	Pako	6	0.20 €	1.20 €
11	Fosfat Cement	Pako	16	8.00 €	128.00 €
12	freza fisurale per dhe ovale per turbin	copë	300	1.30 €	390.00 €
13	freza qeliku dhe diamanti per kunderkand(ovale+ konike	copë	268	0.50 €	134.00 €
14	Glasjonmer	copë	8	0.90 €	7.20 €
15	Gutaperka	Pako	16	4.00 €	64.00 €
16	Jodoform gazë	copë	10	1.00 €	10.00 €
17	Kavit	copë	20	4.50 €	90.00 €
18	Kompozita Fllow ( langshëm)	copë	12	0.12 €	1.44 €
19	Kurore Celulalidi	Pako	4	0.01 €	0.04 €
20	Lentyla	copë	16	5.00 €	80.00 €
21	Llampa e shpirtusit	copë	3	3.00 €	9.00 €
22	Mbajts matrice	Pako	6	5.00 €	30.00 €
23	Nervheqsa(ekstirpator)	copë	60	6.00 €	360.00 €
24	Kunja para pulpar	Pako	12	5.00 €	60.00 €
25	Solucion Clumsik(ose eugenol)	copë	16	7.00 €	112.00 €
26	Sprej me ksiolokain 10%	copë	21	15.00 €	315.00 €
27	Sprej per turbin	copë	9	6.00 €	54.00 €
28	Thithse per aspiratoe	Pako	52	2.50 €	130.00 €
29	vaterolla per pshtym	Pako	30	2.00 €	60.00 €
30	Zgjerus per kanale 15/40	Pako	30	6.00 €	180.00 €
31	Gellatamp	copë	10	13.00 €	130.00 €
32	Kompozita Fllow ( langshëm)	copë	4	12.00 €	48.00 €
33	Past devitalizuse pa arsenik	Pako	12	28.00 €	336.00 €
34	Kurora celuloidi(komplet)	Pako	10	0.10 €	1.00 €

35	Kunja pulpar	Pako	16	0.50 €	8.00 €
36	Goma për pastrim	copë	120	1.00 €	120.00 €
37	Brusha për pastrim	copë	105	0.50 €	52.50 €
38	Shirenga me gumë 2ml 1x100	pako	50	3.00 €	150.00 €
39	Lidokain-Adrenalin Amp 2ml	copë	2000	0.25 €	500.00 €
40	Sol hidrogjen 3%	Liter	10	3.50 €	35.00 €
41	Dezinfektys per Instrumente	Liter	10	13.00 €	130.00 €
42	Trisan Pasrë	copë	10	0.50 €	5.00 €
43	Zyza mbrojtse per Stomatolog	copë	5	2.00 €	10.00 €
44	Kompozit bllomb A1	copë	15	12.00 €	180.00 €
45	Kompozit bllomb A2	copë	15	14.00 €	210.00 €
46	Kompozit bllomb A3	copë	10	0.10 €	1.00 €
47	Kompozit bllomb B1	copë	10	0.10 €	1.00 €
48	Kompozit bllomb B2	copë	10	0.60 €	6.00 €
49	Matrica harkore	copë	20	6.00 €	120.00 €
50	Matrica shirit	copë	10	0.60 €	6.00 €
51	Zgjerus per kanale 30	Pako	20	4.00 €	80.00 €
52	Zgjerus per kanale 25	Pako	20	0.60 €	12.00 €
53	Zgjerus per kanale 15	Pako	20	0.60 €	12.00 €
54	Zgjerus per kanale 40	Pako	20	0.60 €	12.00 €
	<b>Totali</b>				<b>5,438.98 €</b>



**IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)**

EMRI I OE:	ANDIDENT
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	ADNAN BALA
NËNSHKRIMI:	
DATA:	15.03.18
VULA:	



- 1.
- 2.
- 3.